

**TEST ME MË SHUMË PËRGJIGJE TË DHËNA NGA TË CILAT VETËM NJË ËSHTË E SAKTË**


 (Përgjigjet duke e rrethuar **vetëm një** nga përgjigje e dhëna nën A,B,C ose D)

Çdonjëra përgjigje e saktë sjell 2 pikë

1. Çka nga e mëposhtmeja ndodhë në temperaturë të shkrirjes kur sulfuri i ngurtë kalon në të lëngët?
- Lëvizja e thërmijave përshejtohet.
  - Distanca në mes thërmijave rritet.

- Vetëm I
- Vetëm II
- Edhe I edhe II
- As I as II

2. Cili pohim është i saktë për paraqitjet e mëposhtme?



- Substancë e njejtë është e paraqitur tek I dhe II.
- Substancë e njejtë është e paraqitur tek II dhe III.
- Të gjitha paraqitjet i referohen substancës së njejtë.
- Të gjitha paraqitjet ju referohen substancave të ndryshme.

3. Shënimi simbolik  $3I_2$  nënkupton:

- Tre atome jod
- Tre molekula jod
- Gjashtë atome jod
- Gjashtë molekula jod

4. Ç'farë elektroda më së shpeshti përdoren gjatë elektrolizës së ujit në aparatën e Hofmanit?

- Grafiti
- Platinës
- Bakri
- Hekuri

5. Cili është emërtimi i saktë i komponimit të paraqitur me formulën kimike  $PbO_2$ ?

- Oksid plumbi
- Tetraoksid plumbi
- Oksid plumbi(II)
- Oksid plumbi(IV)

6. Cili opsion (A-D) përmban vetëm ndryshime kimike?

- Paraqitja e ylberit
- Shpërthimi i lëndës plasëse
- Errësimi i argjendit
- Magnezi në ujë
- Guri i kaltër në ujë

- III dhe IV
- I, II, III dhe IV
- II, III dhe IV
- Të gjitha


7. Nëse përzihet tretësirë ujore e nitratit të aluminit dhe hidrosidit të kaliumit, formohet:

- Fundërrinë e verdhë e hidrosidit të aluminit.
- Fundërrinë e bardhë e hidrosidit të aluminit.
- Fundërrinë e verdhë e nitratit të kaliumit.
- Fundërrinë e bardhë e nitratit të kaliumit.

8. Nëse substancat vijuese: *soda bikarbone, pluhur për larje, qumësht dhe zbardhues* renditen sipas aciditetit ashtu që të fillohet me substancën më acidike, në vendin e dytë do të jetë:

- soda bikarbone
- pluhur për larje
- qumësht
- zbardhues

9. Në fotografi është paraqitur vëllimi fillestar(a) dhe i fundit(b) i lexuar nga bureta gjatë ndonjë titrimi. Sa mililitra prej tretësirës janë hargjuar përgjatë titrimit?



- A. 0,75  
B. 1,75  
C. 2,00  
D. 2,25

10. Sa izomerë ka alkani i cili në molekulën e tij ka 14 atome të hidrogjenit?
- A. 5  
B. 6  
C. 7  
D. 8


### PROBLEME TEORIKE

(Përgjigju në përputhshmëri me kërkesat e paraqitura në pyetje. Shkruaje përgjigjen në pjesën e paraparë për të!

#### Detyra 1.

(5)

Gjatë nxehjes së substancave mund të ndodhë ndryshim i gjendjeve agregate. Mund të zhvillohet eksperiment i thjeshtë ashtu që do të ndjeket ndryshimi i temperaturës përdorues substancave nxehet. Të dhënat e fituara mund të paraqiten me ndihmën e lakores së nxehësisë. Në fotografi është e paraqitur një lakore e tillë tek e cila është treguar ndryshimi i temperaturës në varshmëri prej energjisë së dhuruar (në formë të nxehësisë). Lidhi pohimet nga që të dy kolonat ashtu që tek çdonjëri interval (a-b, b-c dhe kështu me rradhë) do të bashkangjitet vetëm nga një numër (1-5) i cili përputhet me pohimin e saktë.



a-b	1	Gjatë nxehtjes së substancës së lëngët, energjia kinetike e thërmijave rritet, ndërsa temperatura ngritet.
b-c	2	Kjo është temperatura e vlimit. Tash ka energji të mjaftueshme për t'u shkëputur lidhjes në mes thërmijave dhe të formohet gaz. Këtu është e nevojshme energji më e madhe se nga ajo për shkrirje pasi që të gjitha lidhjet në mes thërmijave duhet të shkëputen. Temperatura ngelet konstante pasi nuk ka rritje të energjisë kinetike. Në tretësiirë vërehen fluska nga faza avulluese e substancës.
c-d	3	Kjo është temperatura e shkrirjes. Thërmijat largohen nga pozitat e tyre pothuajse fikse dhe formohet lëng. Energjia e dhuruar në këtë fazë përdoret për shkëputje të lidhjeve në mes thërmijave, dhe jo për rritje të energjisë kinetike. Prandaj temperatura ngelet konstante.
d-e	4	Gjatë nxehtjes së substancës së gaztë, rritet energjia kinetike e thërmijave, ndërsa temperatura ngritet.
e-f	5	Gjatë nxehtjes së substancës së ngurtë, rritet energjia e thërmijave, ndërsa temperatura ngritet.

## Detyra 2.

(6)

Pohimet a-f përshkruajnë elemente ose substanca të thjeshta të ndërtuara nga një element. Në tabelën në fotografi (pjesë e Sistemit periodik) futi **shkronjat a-f** të cilat ju përputhen elementit të përshkruar (ose substancës së thjeshtë). Mos i shkruaj simbolet e elementeve kimike.

1						18	
	2		13	14	15	16	17

- a – Gaz pa ngjyrë tek i cili një numër i madh i substancave mund të digjen.
- b – Element metali i cili hyn në përbërjen e mermerit.
- c – Gaz me ngjyrë të verdhë në të gjelbër i formuar prej molekulave dyatomike.
- d – Gaz që nuk reagon i cili është më i përhapur në ajër.
- e – Element nga i cili formohen dy substanca të thjeshta- diamanti dhe grafiti.
- f – Tretësirë që nuk përçon elektricitet.

## Detyra 3.

(6)

Për çdonjërin nga fotografitë në tabelën e mëposhtme rretho PO nëse kur lëshohet rrymë elektrike llamba ndriçon ose JO nëse nuk ndriçon.

<p>Merkur PO    JO</p>	<p>Tretësirë ujore e sulfat bakrit(II) PO    JO</p>	<p>Tretësirë ujore e klorur natriumit PO    JO</p>
<p>Grafit PO    JO</p>	<p>Diamant PO    JO</p>	<p>Sulfur PO    JO</p>

Plotëso!


Gjatë elektrolizës së përzierjes nga uji dhe acidi sulfurik fitohet \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ në raport \_\_\_\_\_.

Gjatë elektrolizës së ujit fitohet \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ në raport \_\_\_\_\_.

**Detyra 4.**

(3)

Në paraqitjen e mëposhtme është dhënë strukturë e thjeshtuar e diamantit.



Diamanti paraqet \_\_X\_\_. Në paraqitjen e mësipërme çdonjëri rreth paraqet \_\_Y\_\_ të \_\_Z\_\_.

Termi i saktë që duhet të shënohet në vendin e X është:

- A. Substancë elementare
- B. Komponim
- C. Përzierje homogjene
- D. Përzierje heterogjene

Termi i saktë që duhet të shënohet në vendin e Y është:

- A. Atom
- B. Molekulë njëatomike
- C. Molekulë dyatomike
- D. Jon


Termi i saktë që duhet të shënohet në vendin e Z është:

- A. Ari
- B. Argjend
- C. Karbon
- D. Sulfur

## EKSPERIMENT I PARAMENDUAR

(10)

Destilimi është procedurë për ndarje të komponentëve nga përzierja në bazë të \_\_\_\_\_. Në fotografi është paraqitur mjet me ndihmën e së cilit mund të zhvillohet kjo procedurë. **C** gjendet para enës **B** dhe quhet \_\_\_\_\_. Në **C** \_\_\_\_\_ ujë (i ftohtë dhe i ngrohtë) futet në vendin e simbolizuar me shkronjën \_\_\_\_\_.




Aleksandra është dashur të zhvilloj eksperiment me anë të së cilit do t'i ndajë komponentat nga uji i detit. Për atë qëllim ajo ka përdorur destilim të thjeshtë. Nëse në poç matës(kollbë) ka vendosur ujin e detit, atëherë në enën tjetër laboratorike ka fituar \_\_\_\_\_.

Martini ka kryer tjetër eksperiment tek i cili është dashur t'i ndajë tre lëngje prej përzierjes së tyre me ndihmë të destilimit (shiko fotografinë më lart). Nëse në poç matës(kollbë) ka tre tretësira **X**, **Y** dhe **Z**, vetitë e të cilave janë të dhëna në tabelën e mëposhtme, atëherë tretësira \_\_\_\_\_ (*X, Y ose Z*) e para do ta lëshoj poçin. Kjo procedurë është e njohur me emrin \_\_\_\_\_.

	$T_{sh} / ^\circ C$	$T_v / ^\circ C$	Dendësia/ $kg/m^3$	Ngjyra
X	-116,3	34,6	713,3	Tretësirë pa ngjyrë
Y	0	100	997	Tretësirë pa ngjyrë
Z	-114,1	78,37	789	Tretësirë pa ngjyrë

Ndërsa, Zuljeta, është dashur të zhvilloj destilim për të ndarë komponentët nga përzierja e panjohur. Ajo e ka nxehur përzierjen në aparaturë të përshtatshme për destilim (shiko fotografinë më lart). E ka matur temperaturën menjëher pasi është paraqitur pika e parë e destilatit në enë, ndërsa më pas e ka matur temperaturën e çdonjëres nga disa pika destilat. Nga të dhënat e fituara për temperaturën dhe vëllimin e destilatit ka vizatuar lakore të destilimit sikur ajo e mëposhtmeja.



Në bazë të informatave të eksperimentit të Zuljetës, përgjigju në pyetjet vijuese:

- 1) Prej sa komponentave (substancave të thjeshta) përbëhet përzierja?  
\_\_\_\_\_
- 2) Cilat janë temperaturat e tyre të vlimit?  
\_\_\_\_\_
- 3) Cili është raporti i komponentave (substancave të pastërta) në përzierje?  
\_\_\_\_\_